

**MARRËVESHJE**  
**BASHKËPUNIMI NË FUNKSION TË KËRKIMIT SHKENCOR**

Mes

**Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shqipëri**

Dhe

**Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë**

**(Union of Chambers of Commerce and Industry of Albania)**

Duke u njohur me rëndësinë e shkëmbimeve në fushën e kërkimit shkencor dhe orientimit të aktiviteteve akademike nga zhvillimet ekonomike dhe nevojat e tregut të punës, po ashtu edhe mundësitë e siguruara nga forcimi i kontakteve mes anëtarëve të fakulteteve dhe studentëve të institucioneve me komunitetin e biznesit, **Universiteti i Shkodrës** dhe **Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë** nënshkruajnë marrëveshjen e mëposhtme në fushën e bashkëpunimit akademik dhe të kërkimit shkencor.

**Neni 1**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është inkurajimi i shkëmbimeve mes **Universitetit të Shkodrës dhe Bashkimi të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë** në të gjitha fushat prezente në të dy institucionet.

**Neni 2**

Bashkëpunimi mes dy institucioneve respektive duhet të nxisë aktivitetet e mëposhtme:

- Shkëmbime dhe bashkëpunime reciproke të profesorëve, kërkuesve, studentëve dhe stafit tjetër në nivelin universitar dhe pas universitar me perfaqësuesit e bizneseve dhe aktorët e tjerë me impakt në zhvillimin ekonomik të vendit;
- Organizimi i shkollave verore, seminareve, dhe formave të tjera shkëmbimi njohurish nga palët dhe në funksion të interesave të veçanta ng të dyja palët;
- Kryerjen e kërkimeve shkencore nga stafet akademike dhe studentët e të gjitha cikleve të studimit në funksion të nevojave të bizneseve;

- Realizimi i projekteve të përbashkëta;
- Shkëmbime eksperiencash në programe reciproke në të gjitha specialitetet e në mënyrë të veçantë në fushën e ekonomisë, biznesit, sistemeve të informacionit dhe komunikimit etj;
- Shkëmbim të stafëve akademike, stafëve administrative nga Universiteti me ekspertë të specialiteteve të ndryshëm nga bizneset me qëllim përfitim eksperience dhe përshtatje të aktiviteteve akademike, programeve të studimit të gjitha cikleve dhe punës kërkimore shkencore sipas sipas nevojave të tregut;
- Bashkëpunimi në fushën e reformës universitare sipas Deklaratës së Bolonjës dhe Deklaratës së Lisbonës në përshtatje me kërkesat e zhvillimeve ekonomike në vendin tonë dhe të nevojave të bizneseve;
- Si dhe forma të tjera bashkëpunimi me qëllim që të jenë reciprokisht përfituese për të dyja palët.

### **Neni 3**

Të gjitha aktivitetet e përmendura në Nenin 2 do të bazohen mbi reciprocitet.

### **Neni 4**

Të dy Institucionet të paktën një herë në vit do bien dakort mbi format dhe fushat konkrete të bashkëpunimit. Këto programe të përbashkëta mund të ndryshohen dhe të amendësohen nga një marrëveshje e shkruar dhe e firmuar nga të dyja palët.

### **Neni 5**

Aktivitetet e përbashkëta do të rishikohen çdo vit.

### **Neni 6**

Marrëveshja prezente nënshkruhet si një marrëveshje e vazhdueshme pa limite kohore.

### **Neni 7**

Marrëveshja hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

### **Neni 8**

Secili Institucion ka të drejtë të propozojë aneksime dhe ndryshime të dokumentit në formë të shkruar dhe ndryshimet do fillojnë pas përshtatjes së tyre nga palët.

### Neni 9

Secili Institucion ka të drejtë të ndërpresë marrëveshjen prezente duke paraqitur një lajmërim me shkrim të paktën gjashtë muaj para afatit.

### Neni 10

Aktivitetet që nuk janë përfshirë në këtë Marrëveshje do akordohen nga palët, të cilat do vazhdojnë të kenë kontakte, vullnetin e mirë, fleksibilitetin dhe cilësinë e adaptueshme për realizimin e kësaj marrëveshjeje.

### Neni 11

Kjo Marrëveshje do paraqitet në dy kopje identike në gjuhën shqipe. Secili Institucion do marrë nje kopje .

**Prof. dr. Adem Bekteshi**

**Rektori  
Universiteti i Shkodrës  
"Luigj Gurakuqi"**



*W= 4097 Post*

*dt 21.11.2019*

Emri \_\_\_\_\_



Data 10 Janar 2020

Vendi Tiranë

*N: 2 PROT*

*date 10.01.2020*